

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7075
E mërkurë, 20 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

KMDLNj-ja: Ministria e Drejtësisë, pa qëndrim korrekt ndaj pengjeve që po mban Specialja | FQA 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS PËRPLASIN PUSHTETIN DHE OPOZITËN | FQA 4-5

OPOZITA: PUSHTETI KA FRIKË NGA KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA


OPINION

PRESIDENTJA E PËRÇARJES DHE E URREJTJES, VJOSA OSMANI! F. 9

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



MUSLIU-SHOSHI: QEVERIA PËRJASHTOI KATEGORITË E LUFTËS NGA SUBVENCIONIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE F. 6

PACOLLI PADITË ABDIXHIKUN, RAMËN DHE KICA-XHELILIN: SHPIFËN DHE MË DENIGRUAN PËR 'RRUGËN A' F. 6

SELIMI: SERBIA NË BE, 100 PËR QIND E KUSHTËZUAR ME KOSOVËN NË OKB F. 5

EKONOMI

HOVENIERI: SHBA-JA DO TË VAZHDOJË TA MBËSHITESË KOSOVËN PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME ENERGJETIKE F. 8

SPORT



SHKËLQEJNË GJIMNASTET E 'ELITËS', KTHEHEN ME MEDALJE NGA GJERMANIA F. 10



Lëvizja Vetëvendosje e ka akuzuar opozitën për bllokimin e reformave të iniciuara nga qeveria Kurti. Sipas partisë në pushtet, opozita është duke e shfrytëzuar Gjykatën Kushtetuese për ta penguar punën

e qeverisë. Ndaj këtyre akuzave ka reaguar opozita. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LDK-së kanë vlerësuar se pushteti është duke u frikësuar nga kushtetutshmëria dhe ligjshmëria prandaj, sipas tyre,

Vetëvendosja është në panik. Nga dy partitë opozitare kanë thënë se kontestimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga partia në pushtet është i rrezikshëm për demokracinë e Kosovës

KURTI S'E PËRJASHTON MUNDËSINË E SULMEVE TË REJA NGA SERBIA F. 7



BE-ja E SHOQËTËSUAR, SERBIA NUK E ZBATON MARRËVESHJEN E OHRIT F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sekuestrohen 107 vepra arti në Shqipëri që i përkasin antikitetit grek


TRANË, 19 DHJETOR - Policia e Fierit në Shqipëri ka sekuestruar 107 vepra arti që dyshohet se janë trafikuar nga Greqia. Disa prej tyre i përkasin periudhës së antikitetit. Për trafikimin e tyre janë arrestuar dy persona, 51 dhe 57 vjeç. Policia ka thënë se ata akuzohen për trafikim të veprave të artit dhe kulturës. "Vlera e veprave të çmuara arkeologjike që janë trafikuar nga shteti grek kap vlerën e 1.5 milion eurove. Ndër veprat e sekuestruara janë ikona dhe piktura të autorëve grekë dhe rumunë, shpata dhe sende të tjera që dyshohet se i përkasin periudhës së antikitetit, një kokë mermeri e dyshuar e shekullit të

dytë para lindjes së Krishtit", ka thënë drejtori i policisë së Fierit, Lorenc Panganika. Gjatë kontrollit në banesat e dy të ndaluarve është gjetur edhe një sasi e vogël droge kanabis sativa, municion luftarak dhe një furgon që përdorej për transportin e veprave arkeologjike, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provave materiale. Zyrtarë të policisë dhe prokurorisë në Fier kanë bërë me dije se do të bashkëpunohet me policinë greke për të zbardhur dhe dokumentuar këtë veprimtari kriminale dhe për t'i përballur me drejtësinë edhe shtetasit e tjerë të implikuar.



Pak ditë më parë, më 15 dhjetor, Shqipëria ia ktheu 20 ikona fqinjës së saj, Maqedonisë së Veriut, të cilat ishin vjedhur para një dekade. Ato ishin pjesë e 476 ikonave të vjedhura, që Policia e Shqipërisë i kishte sekuestruar në vitin 2013. Asokohe ishte themeluar një grup punues për vlerësimin dhe kategorizimin e ikonave të kapura, për të kuptuar se nga vinin dhe kujt i përkisnin. Marrëveshja për kthimin e tyre u nënshkrua më 14 nëntor të vitit 2022 gjatë një mbledhjeje të përbashkët të dy qeverive në Shkup, ku u ekspozua në mënyrë simbolike ikona e "Shën Ilisë".

Britania dhe Franca do ta mbështetin Ukrainën për aq kohë sa të jetë e nevojshme



Paris, 19 dhjetor - Britania dhe Franca do të vazhdojnë të jenë mbështetëse të zjarra të Ukrainës për aq kohë sa të jetë e nevojshme, ka thënë sekretari i Jashtëm britanik, David Cameron, pas një takimi me homologun francez, Katrin Colonna. Cameroni i ka bërë thirrje Perëndimit të tregojë durim. Në Ukrainë shqetësimi është duke u rritur nëse mbështetja globale do të vazhdojë pasi konflikti në

Lindjen e Mesme ka larguar vëmendjen nga vendi. Gjithashtu, ekziston një pasiguri në lidhje me mbështetjen financiare perëndimore, veçanërisht mbështetjen e ShBA-së që shkon drejt votimit. Kremli ka njoftuar se "Rusia ishte duke pritur për paketën më të fundit, të 12 sanksioneve të Bashkimit Evropian kundër saj, kryesisht për diamantet ruse", duke theksuar se do të

gjejë mënyra për t'i anashkaluar ato. Ndërsa shefi i OKB-së për të drejtat e njeriut, Volker Turk, ka thënë se kishte parë dështim nga ana e Rusisë për t'i mbrojtur civilët në Ukrainë dhe se ka indikacione se forcat ruse kanë kryer krime lufte. Në mars, Gjykata Penale Ndërkombëtare ka lëshuar një urdhër arrest për Vladimir Putinin për çështjen e rrëmbimit të dyshuar të fëmijëve nga Ukraina.

Gjermania pranon të dërgojë mijëra trupa në kufirin rus

BERLIN, 19 DHJETOR - Një brigadë gjermane prej rreth 4 800 ushtarësh të vendosur përgjatë kufirit Lituani - Rusi do të jetë në gatishmëri luftarake në vitin 2027, kanë thënë ministrat e mbrojtjes. Marrëveshja midis Gjermanisë dhe Lituanisë do ta shënojë dislokimin e parë të përhershëm të trupave gjermane që nga Lufta e Dytë Botërore, shkruajnë mediet e huaja. Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, e ka krahasuar marrëveshjen "historike" me vendosjen e forcave aleate në Gjermaninë Perëndimore, të cilat u



vendosën për ta mbrojtur Evropën Perëndimore në rast të një sulmi sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë. "Krahu lindor tani është zhvendosur në lindje dhe është detyrë e Gjermanisë ta mbrojë atë", ka thënë Pistorius. Shumica e njësive do të mbërrin më 2025 dhe 2026 dhe atyre dhe familjeve të tyre do t'u ofrohen "kushte tërheqëse", duke përfshirë shkollet në gjuhën gjermane, strehimin dhe lidhjet e fluturimit, ka thënë ministri gjerman. "Shpejtësia e projektit tregon qartë se Gjermania e kuptoi realitetin e ri


të sigurisë", ka thënë ai, duke shtuar se Gjermania tashmë drejton grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s në Lituani prej rreth 1 000 trupash, të cilat do të integrohen në brigadë. Pas fillimit të agresionit rus të Ukrainës në shkurt 2022, NATO është zotuar ta forcojë praninë e saj në kufirin lindor të aleancës. Ndryshe, një institut i ekspertëve amerikanë që ka paralajmëruar Vladimir Putinin po përgatit Rusinë për një "luftë konvencionale të mundshme në shkallë të gjerë kundër NATO-s".

Sarajeva, qyteti me ajrin më të ndotur në botë

SARAJEVË, 19 DHJETOR - Kryeqyteti i Bosnjë-Hercegovinës, Sarajeva, është në krye të listës së qyteteve me ajrin më të ndotur në botë, sipas të dhënave të platformës "AirVisual", e cila mbledh informacione nga stacionet matëse në gjithë botën. Pas Sarajevës renditet qyteti

Lahore në Pakistan, Kolkota në Indi dhe Beogradi i Serbisë. "Ata që vuajnë prej sëmundjeve të zemrës dhe mushkërive, gratë shtatzëna, fëmijët dhe të moshuarit, duhet ta shmangin çdo aktivitet në ambiente të jashtme. Të gjithë të tjerët duhet t'i shmangin qëndrimet e gjata

jashtë", ka theksuar organizata Ecoakcija, e cila mbledh të dhëna për cilësinë e ajrit në qytetet e Bosnjë-Hercegovinës. Nga vendet e tjera të rajonit, Shkupi është në vendin e tetë dhe Zagrebi në vendin e 13-të, ndërsa Prishtina në vendin e 19-të.



VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS PËRPLASIN PUSHTETIN DHE OPOZITËN

Opozita: Pushteti ka frikë nga kushtetutshmëria dhe ligjshmëria

Lëvizja Vetëvendosje e ka akuzuar opozitën për bllokimin e reformave të iniciuara nga qeveria Kurti. Sipas partisë në pushtet, opozita është duke e shfrytëzuar Gjykatën Kushtetuese për ta penguar punën e qeverisë. Ndaj këtyre akuzave ka reaguar opozita. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LDK-së kanë vlerësuar se pushteti është duke u frikësuar nga kushtetutshmëria dhe ligjshmëria prandaj, sipas tyre, Vetëvendosja është në panik. Nga dy partitë opozitare kanë thënë se kontestimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga partia në pushtet është i rrezikshëm për demokracinë e Kosovës

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Lëvizja Vetëvendosje e ka akuzuar opozitën se është duke e shfrytëzuar Gjykatën Kushtetuese për t'i bllokuar reformat që ka nisur qeveria Kurti. Sipas kësaj lëvizje, veprimet e opozitës nuk kanë të bëjë me opozitëbërje, por me mbrojtjen e shtetit të kapur. "Opozita e paalternativë vazhdon ta shfrytëzojë Gjykatën Kushtetuese për ta mbrojtur shtetin e kapur dhe për t'i mbrojtur të fuqishmit e ekonomisë dhe privatizimit. Pra, nga njëra anë ajo dërgon Ligjin për Byronë e Konfiskimit të Pasurisë dhe atë për Këshillin Prokurorial, kurse në anën tjetër Ligjin për Çmimet tavan dhe atë për Fondin Sovran. Në mungesë të kritikës së mirëfilltë dhe alternativave ndaj propozimeve e vendimeve tona, me qëllim bllokimin e reformave tona transformuese e progresiste, vazhdojnë të dërgojnë ligje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo nuk ka të bëjë me opozitëbërje. Kjo është përpjekje e Klubit të Stërvjetëruar Politik që t'i ruajë grupet e interesit në mënyrë që të ruhet pasuria e tyre", është thënë në reagimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

Opozita akuzon pushtetin për kontestimin e vendimeve të Kushtetueses

Ndaj këtyre akuzave kanë reaguar përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti ka dështuar në qeverisje në këto tri vjet. Në këtë kontekst, Tahiri ka thënë se pushteti "tani ka filluar të mbajë ligjëratë kotë se si bëhet opozita". "Vetëvendosja, pasi ka dështuar në qeverisje në këto tri vjet, paska filluar të mbajë ligjëratë kotë se si



bëhet opozita. Atyre që kanë bërë opozitë me tym e flakë, me gurë e me gaz, nuk po u pëlqyeka opozita jonë me rrugë institucionale, opozita jonë duke dërguar në Gjykatën Kushtetuese vendimet e tyre të mbrapshta. Ata frikësohen nga kushtetutshmëria dhe

ligjshmëria, prandaj janë në panik. Në vend se t'i mbajnë ligjëratë opozitës, Vetëvendosja duhet ta braktisë vetë rrugën e qeverisjes korruptive dhe të dëmshme, pasojat e së cilës sot po i vërejmë me inflacionin dhe varfërimin e qytetarëve dhe nesër do t'i vërejmë

edhe më qartë me ikjen masive të qytetarëve nga keqqeverisja e tyre", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Ndërsa zëdhënësja e LDK-së, Sibel Halimi, ka thënë se kontestimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga partia në pushtet është i rrezikshëm për demokracinë e vendit. Halimi ka thënë se ligjet e rrëzuara nga Gjykata Kushtetuese do të duhej ta këndellnin pushtetin. "Qasjen e partisë në pushtet ndaj shtetit si projekt i përkohshëm e dëshmojnë edhe veprimet për ta zbatuar këtë ide. Kontestimi i vendimeve kushtetuese me qëllim të propagandimit kundër Lidhjes Demokratike, i rrezikshëm për frymën e krijuar të LV-së kundër institucioneve të vendit. Është tejet e rrezikshme për demokracinë dhe konstruksionin tonë shtetëror, sfidimi që pushteti ia bën kushtetutshmërisë së vendit", ka

shkruar Halimi në "Facebook". Sipas saj, propaganda e LV-së nuk do të mund t'i mbulojë dështimet e qeverisë Kurti. "Ligjet e rrëzuara nga Gjykata Kushtetuese, në vend se ta këndellnin pushtetin për humnerën ku po e dërgon vendin, po përdoren nga ky i fundit si arsenal për artilerinë e propagandës. Propaganda klishe e përbërë nga narrativa populiste e stërpërdorur nuk mbulon kurrësi dështimin kolosal në secilin sektor të pushtetit, i cili në fundosje e sipër do t'i marrë të gjithë me vete në rrënim", ka shkruar Halimi. Kujtojmë se shumicën e ligjeve të cilat i ka adresuar opozita në Gjykatën Kushtetuese janë shpallur si antikushtetuese. Pavarësisht kësaj, kjo nuk është hera e parë që Lëvizja Vetëvendosje kritikon opozitën sidomos për mënyrën se si ka qeverisur në të kaluarën.

Miftaraj tallet me LV-në: Me siguri edhe Komisioni i Venecias është i kapur nga opozita

Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka ironizuar me reagimin e Vetëvendosjes, e cila e ka akuzuar opozitën se po ia dërgon ligjet në Gjykatën Kushtetuese. Miftaraj ka thënë se "me siguri edhe Komisioni i Venecias është i kapur nga opozita". "LV-ja akuzon opozitën pse po i

dërgon ligjet në Kushtetuese. Kjo i bie njëjtë si: Hajni akuzon policin që e arrestoj në flagrancë gjatë grabitjes së bankës. Po Komisioni i Venecias pse po ua rrëzon çdo iniciative ligjore që po e dërgoni? Me siguri edhe Komisioni i Venecias është i kapur nga opozita dhe grupet e interesit", ka shkruar Miftaraj në "Facebook".

Vonohet presidentja, dështon takimi Osmani - Haradinaj

Prishtinë, 19 dhjetor - Ka dështuar takimi i paraparë në mes të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryetarit të AAK-së, Ramush Haradinaj, në të cilin pritej të diskutohet për përmbajtjen e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ky takim ishte planifikuar të mbahet të hënën, pasi presidentja Osmani ta përfundonte takimin me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, por takimi kishte zgjatur më shumë sesa që ishte paraparë

dhe kjo kishte shtyrë që Haradinaj të largohet nga objekti i Kuvendit. Deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka bërë me dije se presidentja Osmani është vonuar për takim. "AAK-ja ka qenë e gatshme. Kryetari i AAK-së ka shprehur gatishmëri të takohet. Sa kam informacione, presidentja është vonuar në takim dhe zoti Haradinaj me të drejtë nuk ka pritur më shumë", ka thënë Lekaj për "RIV21". Ndërsa nga Presidenca kanë thënë se takimi i Osmanit me

Haradinajn nuk është realizuar për shkakë protokollare. Kujtojmë se kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka refuzuar të takohet me presidenten Osmani për të diskutuar lidhur me draft-statutin e Asociacionit. Kurse, siç ka njoftuar Presidenca, Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku kanë biseduar për zhvillimet në fushën e sigurisë dhe të politikës së jashtme. Në këtë kontekst, presidentja Osmani i ka falënderuar të gjitha subjektet opozitare për

mbështetjen ndaj institucioneve të sigurisë në përballje me agresionin e Serbisë. Më tutje, presidentja Osmani me Abdixhikun ka diskutuar për draft-statutin e Asociacionit dhe, në këtë kontekst, ka ritheksuar se Gjykata Kushtetuese është institucioni që duhet ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë, duke u udhëhequr nga parimi i pavarësisë dhe profesionalizmit. Ndërsa Abdixhiku e ka njoftuar presidenten lidhur me shqetësimet e LDK-së sa i përket



përmbajtjes së draft-statutit dhe janë diskutuar mundësitë për trajtimin e këtyre shqetësimeve në mënyrë që mos të lejohen dykuptimësi që mund ta dëmtojnë funksionimin e brendshëm të Republikës së Kosovës.



BE-ja e shqetësuar, Serbia nuk e zbaton marrëveshjen e Ohrit

Letra e autoriteteve serbe drejtuar Bashkimit Evropian, se Serbia nuk do ta njohë de facto Kosovën, ashtu siç i kërkohet, se nuk e respekton integritetin e saj territorial, sikundër nuk do të pajtohet për anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizatat përcjellëse të saj, ka ngritur shqetësim brenda organizatës evropiane. Pavarësisht prej kësaj, për BE-në, marrëveshja e Ohrit, ndonëse nuk është nënshkruar nga palët, ajo cilësohet ligjërisht e obligueshme. “Marrëveshja në tërësi mbetet ligjërisht obliguese dhe se palët ishin pajtuar për këtë në Ohër. Zbatimi i saj do të jetë pjesë integrale e rrugëtimit përkatës evropian”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Bashkimi Evropian (BE) është i shqetësuar pas qëndrimit të Beogradit se nuk do t'i zbatojë pikat e marrëveshjes së Ohrit që është arritur në kuadër të dialogut me Kosovën. Prishtina ka kërkuar nga BE-së të “heqë dorë nga politika e zbutjes së Serbisë”. Letra e autoriteteve serbe drejtuar Bashkimit Evropian, se Serbia nuk do ta njohë de facto Kosovën, ashtu siç i kërkohet, se nuk e respekton integritetin e saj territorial, sikundër nuk do të pajtohet për anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizatat përcjellëse të saj, ka ngritur shqetësim në BE. Kjo sepse me të bëhet i qartë moszbatimi i marrëveshjes së Ohrit, e dakorduar në fillim të këtij viti në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Për Bashkimin Evropian marrëveshja e Ohrit, ndonëse nuk është nënshkruar nga palët, ajo cilësohet ligjërisht e obligueshme. “Marrëveshja në tërësi mbetet ligjërisht obliguese dhe se palët ishin pajtuar për këtë në Ohër. Zbatimi i saj do të jetë pjesë integrale e rrugëtimit përkatës evropian”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Zyrtarë të Bashkimit Evropian (BE) kanë thënë se “marrëveshja është e detyrueshme në tërësinë e saj për të dyja palët dhe se zbatimi i saj do të jetë pjesë integrale e rrugës së tyre përkatëse evropiane”. Kjo kërkohet nga deklarata e përbashkët nga takimi i fundjavës së shkruar i nivelit të lartë të BE-së me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor, ku është thënë se “BE-ja kërkon marrëdhënie të mira fqinjësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “U bëjmë ftesë të dyja palëve që në tërësi ta zbatojnë Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve dhe aneksin e saj, si dhe të gjitha marrëveshjet nga e kaluara, pa asnjë vonesë të re dhe pa parakushte”, është thënë në deklaraten në pjesën që i kushtohet raporteve mes Kosovës dhe Serbisë.

Bërnabiqi: Pajtimi me deklaraten nuk përfshin pajtimin për anëtarësimin e Kosovës në OKB

Kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, deklaraten e Samitit të

BE-së e ka cilësuar “një deklaratë politike që nuk është ligjërisht e detyrueshme”. “Marrëveshja konsiderohet e pranueshme vetëm në kontekstin në të cilin nuk përfshihet njohja de facto apo de jure e Kosovës. Pajtimi me deklaraten nuk përfshin pajtimin për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në sistemin e organizatave dhe agjencive të OKB-së, e as të ashtuquajturën tërësi tokësore të Kosovës”, është thënë në një njoftim nga zyra e kryeministres së Serbisë. Sipas zëdhënësit të BE, Stano, marrëveshja dhe aneksi për zbatim “janë bërë ligjërisht obliguese përmes komunikatës me shkrim të përfaqësuesit të lartë të BE-së Josep Borrell, më 18 mars 2023”. Por, sipas kryeministres së Serbisë, Ana Bërnabiq, kjo deklaratë “konsiderohet si ligjërisht joobliguese”, dhe se “nuk e ka peshën e marrëveshjes ndërkombëtare sipas së drejtës ndërkombëtare”. “Kosova është pjesë integrale e Republikës së Serbisë nën administrim ndërkombëtar, në përputhje me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së”, ka thënë Bërnabiq.

Reagimi nga Prishtina

Autoritetet e Prishtinës kanë reaguar pas refuzimit të Serbisë që ta zbatojë marrëveshjen e Ohrit, duke i kërkuar komunitetit ndërkombëtar që, siç thonë, “të heqë dorë nga politika e zbutjes së Serbisë”. “Serbia shpreh refuzimin për t’i zbatuar dispozitat e marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit. I bëj thirrje komunitetit ndërkombëtar të pranojë se politika e zbutjes ndaj Serbisë ka dështuar. Tani nevojitet një

ndryshim thelbësor”, ka shkruar në platformën “X”, ministria e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla.

“Serbia me këtë letër edhe një herë u tregua destruktive”

Por si e shohin analistët politikë refuzimin e Serbisë për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit dhe këtë zhvillim të ri në dialogun Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Gazmir Raci, analist politik, i ka thënë “DW”-së se “Serbia me këtë letër edhe një herë u tregua destruktive duke u tërhequr nga ajo që e ka pranuar në procesin e dialogut”, dhe me këtë, “ia përplasi në fytyrë” BE-së gjithë dokumentet dhe angazhimin gati 15-vjeçar në procesin e dialogut. “Në samitin e fundit u tha që të gjitha obligimet e dala nga dialogu do të jenë pjesë edhe e kapitullit 35 për Serbinë në rrugëtimitin e saj për në BE. Ai kapitull që nga fillimi ka qenë kryekëput për obligimet që i ka Serbia në raport me normalizimin e raporteve me Kosovën. Kapitulli 35 tashmë po përditesohet edhe me kërkesën e dalë nga plani franko-gjerman për njohjen de-facto të Kosovës nga Serbia. Edhe deklarata e kancelarit gjerman, presidentit Macron dhe kryeministres italiane Meloni, pas takimit të fundit me Kurtin dhe Vuçiqin, ishte që Serbia tashmë de-facto duhet ta njohë Kosovën”, ka thënë analisti Raci. Edhe një analist tjetër, Blerim Burjani, i ka thënë “DW”-së se në vazhdimësi BE-ja është përballur me këtë qëndrim rezistues të Serbisë, por shpresat dhe vullneti i BE-së për normalizim e tejkalon këtë kokëfortësi politike serbe. “Prandaj BE-ja përsërit se marrëveshja është obligative për zbatim, pra një obligim i pashmangshëm”, ka thënë

Burjani.

Sipas analistit Burjani, Serbia në njërin anë shkon në dialog, ndërsa në anën tjetër refuzon zbatimin e marrëveshjes me Kosovën nëse nuk është në interes të saj. Prandaj, BE-ja, sipas tij, “duhet ta ndryshojë modalitetin e komunikimit me Serbinë, duhet të jetë politikisht më energjike dhe më insistuese”. “Serbia do politika neutrale ndaj zhvillimeve ndërkombëtare dhe do ta mbajë edhe Rusinë afër edhe ndihmat perëndimore apo relacionet me Perëndimin. Politika neutrale është doktrinë e Vuçiqit. Mendoj se dialogu është komplikuar dhe trysnia më lehtë bëhet ndaj Kosovës sesa Serbisë. Qëndrimi i fundit i Serbisë paraqet problem të madh për normalizim të marrëdhënieve, prandaj BE-ja duhet të mendojë saktë se çfarë do nga Serbia dhe t’ia bëjë me dije se do të ketë masa ekonomike në rast se nuk reflekton”, ka thënë Burjani. Më 26 tetor të këtij viti udhëheqësit e Gjermanisë, kancelari Scholz, presidenti i Francës, Macron, kryeministria e Italisë, Meloni dhe të institucioneve të Bashkimit Evropian, pas takimeve të ndara që zhvilluan në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, Kosovës i kërkuar themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbisë njohjen de fakto të Kosovës. Kjo përfshihet edhe në marrëveshjen e Ohrit, e cila, sipas burimeve diplomatike nga BE-ja, thuhet se Këshilli Evropian do t’i kërkojë Komisionit Evropian, që t’i ndryshojë kriteret për anëtarësimin e Serbisë në BE dhe se zbatimi i marrëveshjes së Ohrit të bëhet pjesë integrale e kapitullit të 35 për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian (BE).

KMDLNj-ja: Ministria e Drejtësisë pa qëndrim korrekt ndaj pengjeve që po mban Specialja

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka dalë me një reagim ndaj Gjykatës Speciale, të cilën e ka quajtur "dhunuese të të drejtave të njeriut dhe të personave të privuar nga liria", derisa ka akuzuar ministren e Drejtësisë (MD), Albulena Haxhiun, për mostransparencë.

Sipas KMDLNj-së, Gjykata Speciale ata po i mban në Hagë si pengje, se kjo ministri nuk ka aspak qëndrim korrekt ndaj atyre derisa shton që ajo gjatë vizitave ka bërë dallime në baza partiake. "Dhunuesja e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria që po mbahen si pengje në GjSR në Hagë (të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë), Ekaterina Trandafilova, ishte në një vizitë në Kosovë, siç deklaroi ajo: 'për ta informuar publikun dhe shoqërinë civile për punën e kësaj Gjykate ...'. Pati takime publike dhe të fshehta, për të parat u deklarua publikisht, për të dytat as që ishte në dijeni publiku. Në një reagim të mëhershëm KMDLNj-ja njoftoi opinionin se kjo inkuizitore e të drejtave të njeriut pati një vizitë ilegale në Ministrinë e Drejtësisë, pa e specifikuar se me kë u takua. Realisht, as për KMDLNj-në nuk është me rëndësi se me kë u takua e as për opinionin, por është me rëndësi se kjo ministri fare nuk informoi publikun për këtë takim e as për çka u bisedua. Pastaj, pas vizitës ishte një dënim drakonik ndaj Salih Mustafës dhe një lirim i

vonshëm i Nasim Haradinjat në ndërkohë që Hysni Gucati ishte liruar muaj më parë ndonëse dënimi ishte i njëjtë si dhe vepra (e kurdisur) për të cilën ishin dënuar, gjithashtu me dënime maksimale", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij këshilli, ministrja e kësaj ministrie, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se ajo nuk ishte takuar me kryetaren e Gjykatës Raciste Speciale, por zëvendësi i saj, pa e treguar emrin. "Mungesa e transparencës për këtë takim si dhe llogaridhënies nxitë shumë dyshime aq më parë që dihet publikisht se kjo ministri nuk ka aspak qëndrim korrekt ndaj pengjeve që po mbahen në Hagë sikur që edhe gjatë vizitave ka bërë dallime në baza partiake. Për shkelje drastike të të drejtave të njeriut ndaj pengjeve të Hagës nga kjo gjykatë dhe nga kjo kryetare asnjëherë nuk ka treguar gatishmëri dhe vullnet të kërkojë sqarime, së paku në Kuvendin e Kosovës, me arsytim se nuk dëshiron të ndërhyjë në drejtësi (në situata normale kjo është në rregull) ndërsa, në anën tjetër nuk ka lënë pa komentuar dhe pa ndërhyrë në vendimet e gjykatave të Kosovës sidomos në baza partiake apo edhe për qëllime politike. Kjo ndërhyrje flagrante është theksuar sidomos në Institutin e Mjekësisë Ligjore ku, edhe sot shtirja e ndikimit politik është përtej çdo shqetësimi", ka theksuar KMDLNj-ja në reagim,



duke shtuar "se këmbëngulja për respektim të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, aktualisht pengje, nuk paraqet asnjë ndërhyrje në sistemin e drejtësisë apo në vendimmarrje, por është detyrim i institucioneve të Kosovës aq më parë që botërisht thuhet se kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe MD këtë e thekson shpesh".

"Pastaj, procedura e lirimit me kusht nuk mund të bëhet siç është bërë në rastin Gucati dhe Haradinaj, kriteret janë të përcaktuara dhe nuk mund të shpikë asnjë Gjykatë kushte kufizuese siç është ndalimi i

deklarimit publik deri në kohën kur përfundon kushti. Nëse deklarimi publik ka elemente të natyrës penale është çështje tjetër, atëherë kushti menjëherë zëvendësohet me burg efektív. MD-ja dhe institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë nga GjRS sqarime se si ndodhi që dokumentet e ndjeshme rrodhën nga kjo gjykatë, pse nuk u bënë hetimet pas së cilave do të caktohej përgjegjësia e të gjithë akterëve e jo që kjo rrjedhje e simuluar të keqpërdoret për arrestim dhe dënim të shtetasve të Kosovës aq më parë që GjRS-ja kishte dhe ka përgjegjësi për ruajtjen e këtyre dokumenteve të ndjeshme e jo ai që, në një mënyrë apo tjetër

furnizohet me këto materiale. KMDLNj-ja e ka të qartë se rrjedhja e dokumenteve të ndjeshme nga kjo GjRS është e qëllimshme dhe ka shërbyer për arrestim të kundërligjshëm të presidentit Hashim Thaçi, kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli si dhe shefit të GP të IV-së, Rexhep Selimi. Institucionet e Kosovës kanë heshtur dhe janë treguar shumë oportuniste siç po heshtin sot dhe vazhdojnë të jenë oportuniste. A është ky vetëm një lëshim apo qëllim do ta dëshmojë koha ndonëse për KMDLNj-në nuk ka shumë mëdyshje", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

LDK-ja: Draft-statuti i Asociacionit krijon pushtet të ri në Kosovë

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryesia e re e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në mbledhjen e parë, ka diskutuar për planin e punës, atë organizativ të partisë dhe për çështjet politike kryesore të vendit. Në lidhje me procesin e dialogut, Kryesia e LDK-së ka vlerësuar se draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i cili i është dorëzuar Qeverisë së Kosovës, "përbën qartësisht një rregullim autonom politik dhe territorial të serbëve të Kosovës dhe, si i tillë, kthehet në një çështje urgjente për trajtim kushtetues". "Ky dokument, që buron nga



marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit, mbështetet në Rezolutën 1244 të OKB-së, krijon pushtet të ri

në territorin e Kosovës dhe zëvendëson Gjykatën Kushtetuese me një sistem arbitrazhi", ka

njoftuar LDK-ja. Sipas këtij njoftimi, LDK-ja nuk mund të mbështesë asnjë produkt që del jashtë komizës kushtetuese të Republikës së Kosovës, jashtë sistemit unitar të shtetit tonë dhe jashtë rregullimit territorial të tij. "LDK-ja vlerëson se roli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është i domosdoshëm dhe vendimtar dhe pret që kjo gjykatë të veprojë në përputhshmëri me normën kushtetuese, kurdo që ta trajtojë këtë dokument. LDK-ja konsideron se ky dokument është pasojë e politikave të gabuara të kryeministrit, qeverisë dhe institucioneve të tjera drejtuese të

vendit, si dhe e moskoordinimit me aleatët tanë në fazat më kritike për vendin. LDK-ja beson fort se koordinimi me kohë i veprimeve me aleatët tanë, në veçanti me ShBA-në, është jetik për funksionimin dhe të ardhmen e vendit tonë. LDK-ja vazhdon t'i mbetet besnike idesë fillestare se dialogu me Serbinë duhet të bëhet për njohje reciproke, se Asociacioni i Komunave është obligim yni dhe se ky obligim ndërkombëtar duhet të realizohet në përputhshmëri të plotë me rendin kushtetues të Kosovës", ka njoftuar LDK-ja.

Selimi: Serbia në BE, 100 për qind e kushtëzuar me Kosovën në OKB

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Rruga e Serbisë drejt anëtarësisë në Bashkimin Evropian (BE) është tash "njëqind për qind e kushtëzuar" me rrugën e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ka vlerësuar ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Petrit Selimi.

Këtë vlerësim Selimi e ka bërë

duke komentuar marrëveshjen bazë në mes të Kosovës dhe Serbisë të cilën e ka cilësuar që në fillim si ujdi të arritur "me mungesë ambicie" dhe "mungesë të plotë të besimit nga të gjitha palët". "Marrëveshja e Ohrit mes Kosovës dhe Serbisë ishte befasisht e dobët, e kushtëzuar nga një mungesë

ambicie dhe një mungesë të plotë në të gjitha anët. Por, me të vërtetë siguron të drejtën sovranë të Kosovës për t'u bashkuar në të gjitha organizatat ndërkombëtare. Tash, rruga e Serbisë drejt BE-së është 100 për qind e kushtëzuar me rrugën e Kosovës në OKB", ka shkruar Selimi në "X".



Szunyogu këshillon Aliun t'i japë përparësi zbatimit të legjislacionit për mjedisin

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, është takuar të martën me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu. Në këtë takim ata kanë biseduar për

objektivat ambicioze të shpallura në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike COP28 në Dubai. Gjatë takimit, Szunyogu ka këshilluar Aliun t'i japë përparësi zbatimit të legjislacionit në fushën e mjedisit. "Takova ministrin

Liburn Aliu dhe e falënderova për objektivat ambicioze të shpallura dhe zotimet në COP28. E këshilloj t'i japë përparësi zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike", ka shkruar Szunyogu në "X".



55 studentë përfitues të bursave nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë takuar të martën 55 studentë përfitues të bursave nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, arrijtje të cilën e festuan nën ambientet e Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani". Me këtë rast, Kurti para studentëve është shprehur shumë krenar që ata janë pjesë e universiteteve publike të Kosovës derisa u ka ruar suksese të mëtejme.

"Në vitin akademik 2022/2023 kemi ndarë për herë të parë 26 bursa në vlerë 1 000 euro për studentët e vitit të parë universitar nga komunitetet rom, ashkali,

egjiptian, ndërsa në vitin akademik 2023/2024 po mbështetim me bursa 55 studentë nga këto komunitete, prej tyre 35 vajza dhe 20 djem", ka thënë kryeministri Kurti, duke kujtuar se synimi për vitin e ardhshëm është dyfishimi i numrit.

Përveç studentëve, përfitues të bursave në shumën prej 300 eurosh kanë qenë edhe nxënësit e shkollave të mesme. Njëkohësisht, vazhdon të ketë lehtësime për regjistrimin në klasën e 10-të në shkolla profesionale e gjimnaze, si dhe vende të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet e arsimit të lartë.

Ndërsa ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, pasi ka përgëzuar studentët për përfitimin



e bursës, ka thënë tha se një shoqëri e cila kujdeset për të gjithë qytetarët, një qeveri e cila ofron mbështetjen e merituar për secilin, dhe një shtet që i krijon kushtet secilit të ri dhe të re ta arrijë maksimumin e potencialit të vet, kanë qenë jo vetëm zotimet tona,

por edhe ajo që na ka prirë në programin tonë dhe në jetësimin e këtyre politikave në praktikë.

Në anën tjetër, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, është shprehur se "kjo është qeveria e parë që i mbështet studentët jo vetëm

deklarativisht dhe jo vetëm me rezervimin e një vendi në fakultetet publike, mirëpo edhe një bursë përcjellëse".

Me arsimin në prioritet, Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të angazhohet që për të rinjtë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të ketë kushte më të mira për mësim dhe mbështetje të nevojshme për t'i vazhduar studimet dhe ngritjen akademike dhe profesionale.

Pas fjalimeve hyrëse është zhvilluar edhe bashkëbisedim ndërmjet kryeministrit Kurti, ministrave të pranishëm dhe studentëve përfitues të bursës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët kanë ndarë përvojat e tyre, në të njëjtën kohë kanë falënderuar kryeministrin dhe qeverinë për mbështetjen.

Musliu-Shoshi: Qeveria përjashtoi kategoritë e luftës nga subvencionimi i energjisë elektrike



PRISHTINË, 19 SHTATOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ariana Musliu-Shoshi, ka akuzuar qeverinë Kurti për përjashtimin kategorive të luftës nga subvencionimi i energjisë elektrike. Sipas saj, subvencionimi për këto kategori është i garantuar me ligj. "Albin, pse duhet me paguar rrymën për serbët në veri e jo për ushtarët e UÇK-së, invalidët e luftës, viktimat e dhunës civile e veteranët? Kjo qeveri i ka përjashtuar këto kategori nga subvencionimi i energjisë elektrike

edhe pse si kategori të veçanta e kanë të garantuar me ligj! Mos të harrojmë, kjo qeveri e ka rutinë ditore të shkel ligjet e kushtetutën, mos të flasim për injorimin në vazhdimësi të atyre që dhanë gjithçka për lirinë tone", ka shkruar Musliu-Shoshi në "Facebook".

Ndaj këtij pretendimi ka reaguar ministri i Financave, Hekuran Murati. Ai ka mohuar se i kanë përjashtuar kategoritë e luftës nga subvencionimi i energjisë. "Lajmet e rreme nuk kalojnë! Është e pavërtetë që qeveria ka përjashtuar

ndonjë kategori nga subvencionimi i energjisë elektrike. Përkundrazi, me programin e ri synimi është që të zgjerohet lista e familjeve që mbështeten, si dhe subvencionimi të jetë në bazë të të ardhurave, pra sa më pak të ardhura, aq më i lartë subvencionimi. Programi i ri është në fazën e pilotimit, dhe kemi paraparë edhe një fazë/grup aplikimesh ku pritet të trajtohen sfidat që kemi hasur gjatë fazës/grupit të parë", ka thënë Murati në reagimin e tij.

Pacolli paditë Abdixhikun, Ramën dhe Kica-Xhelilin: Shpifën dhe më denigruan për 'Rrugën A'

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, ka dorëzuar padi kundër kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku, kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama dhe deputetes së LDK-së, Doarsa Kica Xhelili. Ajo ka thënë para medieve se padia ka të bëjë me shpifjet dhe denigrimin që këta të fundit i kanë bërë lidhur me projektin e "Rrugës A".

"Dorëzova padi kundër kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, kundër kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhikut dhe kundër

nënkryetares së LDK-së, deputetes Doarsa Kica-Xhelili, në lidhje me rastin e 'Rrugës A'. Ata shpifin dhe fyejnë dhe denigrojnë autoritetin tim duke më akuzuar pa fakte. Me statuset e tyre publike kanë nxitur opinionin publik kundër meje, kanë nxitur qytetarët e Prishtinës të reagojnë kundër meje pa pasur asnjë fakt dhe në mënyrë shumë të padrejtë. Unë pres që Gjykata ta shqyrtojë me kujdes lëndën time", ka thënë Pacolli.

E pyetur për ndërlidhjen me motrën e saj në këtë çështje,

gjyqtaren Vlora Pacolli, ajo ka thënë se të dyja vetëm po e bëjnë punën e tyre profesionale, mirëpo kjo afërsi e tyre është shfrytëzuar për qëllime politike. "Motra ime ka punën e vet, unë kam punën time. Të dyja e bëjnë punën tonë profesionale. Ata e kanë shfrytëzuar rastin për të përfituar politikisht dhe më kanë akuzuar padrejtësisht veç pse jam motra e gjyqtarës Vlora Pacolli. Ajo e ka pasur rastin e 'Rrugës A' dhe ju e dini që rastet ndahen me rend. Ne presim që gjykata të marrë vendim", ka thënë Pacolli.



Kurti s'e përjashton mundësinë e sulmeve të reja nga Serbia

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Tekave të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk u dihet. Kështu së paku beson kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili, në një intervistë për gazetën gjermane "Stern", rreth potencialitetit të një konflikti apo sulmi eventual ndaj Kosovës nga Serbia, thotë se "nuk e dimë se çka nesër Vuçiqi mund t'i urdhërojë policinë dhe ushtrinë".

Kurti ka thënë se "ne në vazhdimësi ndiejmë agresivitetin e Serbisë" teksa shpjegon organizimin ushtarak serb përgjatë kufirit me Kosovën "si patkua". "Nuk mund ta përjashtojmë", ka thënë Kurti rreth eventualitetit të një konflikti të ri, por shprehet i bindur se "jemi vigilentë". "Kemi mbështetjen e trupave tona dhe ato të NATO-s, që kanë përforcuar qëndrimin e tyre që nga sulmi i shtatorit për ta mbajtur të sigurt vendin tonë", ka thënë Kurti.

Duke folur për sulmin në Banjskë, Kurti i ka thënë medias gjermane se këtu është veç një person - Vuçiqi sepse "Serbia është show i vetëm një njeriu", teksa ka shtuar se burimin e armëve sulmuesit paraushtarakë e kishin nga ushtria serbe.

"Mbarë problemet tona të sigurisë kombëtare, sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial vijnë nga Serbia. Por,

nën qeverisjen time ne kemi marrë veprime të suksesshme kundër krimit të organizuar. Dhe, kjo, i ka bërë disa njerëz në veri tejet nervozë sepse po e përdornin atë rajon për përfitim të vet. Kjo kulmoi në sulmin terrorist më 24 shtator", ka thënë ai.

Por, megjithëkëtë, Kurti i ka thënë "Stern"-it gjerman se marrëveshja bazike për normalizim të marrëdhënieve "është gjallë". Dhe "është gjallë", ka thënë ai, teksa fjalinë e ka vazhduar me atë që "Serbia e shkelë atë çdo javë".

Ndërsa "problemi më i madh", ka thënë Kurti, është heshtja dhe pasiviteti i BE-së, "e cila nuk ndërmerr veprime kur Serbia shkel marrëveshjet".

Kurse "marrjen më të mirë" të Serbisë nga ana e diplomatëve perëndimorë, Kurti e ka quajtur gjithë aspak të duhur. "Nuk funksionon kjo", ka thënë Kurti, duke shtuar se Serbia do të zhvillohet në drejtim të Bjellorusisë. "Ka shumë frikë nga ana evropiane se Serbia do të zhvillohet në drejtim të Bjellorusisë. Zhvillimi tashmë po shkon tërësisht në këtë drejtim. Mbaj mend që miqtë e mi në diplomacinë evropiane më thoshin para zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në prill 2022: 'Pritni zgjedhjet në Serbi do të sjellin një ndryshim



kursi drejt Perëndimit'. Por kjo nuk ndodhi. Shumica e diplomatëve perëndimorë dhe ekspertëve të politikës së jashtme ose kanë frikë se mos e humbasin plotësisht Serbinë, ose besojnë se mund t'i çojnë disi në rrugën drejt Perëndimit - thjesht duhet të presin edhe pak. Por nuk funksionon", ka thënë Kurti. Kurti, mes të tjerash, ka thënë se Beogradi bëhet çdoherë e më "nervoz dhe agresiv" aq më

shumë që Kosova bën mirë për serbët e Kosovës. "Popullsia jonë është 93 për qind shqiptare, por kemi edhe katër për qind serbë dhe minoritete të tjera. Kemi diskriminim pozitiv: 20 nga 120 vendet në parlament janë të rezervuara për pakicat e caktuara, por serbët po bojkotojnë vendet e tyre sepse Beogradi u thotë ta bëjnë këtë. Ne i mbështetim serbët në Kosovë në mënyra të ndryshme:

ndërtojmë shtëpi, ndihmojmë fermerët fillestarë. Ministri im për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç, serb, po kujdeset për këtë. Por sa më shumë të mira të bëjmë për serbët në Kosovë, aq më nervoz dhe agresiv bëhet Beogradi. Në vitet e fundit Beogradi është bërë edhe më nervoz pasi miratimi i degës së partisë së presidentit Vuçiq atje ka rënë në tetë për qind", ka thënë kryeministri Kurti.

BE-ja e shqetësuar për parregullsitë në zgjedhjet e Serbisë

BRUKSEL, 19 DHJETOR - Bashkimi Evropian (BE) pret që autoritetet e Serbisë t'i shqyrtojnë në mënyrë transparente raportet e besueshme për parregullsi në zgjedhjet e 17 dhjetorit. Përmes një deklarate të përbashkët për medie, shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, dhe komisionari për Zgjerim, Oliver Varhelyi, kanë thënë se në mesin e parregullsive gjatë zgjedhjeve parlamentare, lokale dhe krahinore në Serbi, përfshihen edhe ato të raportuara në kryeqytetin serb, Beograd dhe komuna të tjera.

"Ne marrim parasysh gjetjet preliminare dhe konkluzionet e vëzhguesve ndërkombëtarë të Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë dhe Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut për zgjedhjet parlamentare serbe. Në dritë të këtyre gjetjeve, me shqetësim ne vijmë në përfundim se procesi zgjedhor ka nevojë për përmirësim dhe reforma të mëtejme, pasi që funksionimi i duhur i institucioneve demokratike të Serbisë është thelbi i procesit të pranimit të Serbisë në BE", është thënë në deklaratën e përbashkët të Borrellit dhe Varhelyit.



Dy zyrtarët e lartë evropianë i kanë bërë thirrje udhëheqjes politike serbe të sigurojë një dialog konstruktiv dhe gjithëpërfshirës në të gjithë spektrin politik.

Partia Progresive Serbe (SNS) e presidentit Aleksandër Vuçiq ka shpallur fitoren në të gjitha nivelet. Por, partitë e koalicionit opozitar "Serbia kundër dhunës" kanë kërkuar anulimin

e zgjedhjeve lokale në Beograd, duke argumentuar se për shkak të parregullsive të shumta, rezultatet zgjedhore nuk e reflektojnë vullnetin e qytetarëve.

Partitë e koalicionit opozitar "Serbia kundër dhunës" kanë thënë se në zgjedhjet lokale në Beograd ka pasur shumë parregullsi, dhe se rezultatet nuk e reflektojnë vullnetin e

qytetarëve.

Edhe nga vëzhguesi zgjedhor serb, CRTA, kanë deklaruar se rezultatet në Beograd nuk pasqyrojnë vullnetin e qytetarëve.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Republikan Zgjedhor, lista zgjedhore "Aleksandër Vuçiq - Serbia nuk guxon të ndalet" ka fituar 46.71 për qind, pasur nga lista "Serbia

kundër dhunës" me 23.58 për qind.

E treta është radhitur lista "Ivica Daçiç - kryeministër i Serbisë" me 6.57 për qind të votave. Më pas vjen "Shpresa për Serbinë" me 5.03 për qind dhe "Ne - Zëri i Popullit" me 4.69 për qind.

Në zgjedhjet e 17 dhjetorit, banorët serbë të Kosovës kanë udhëtuar drejt Serbisë për të votuar. Kjo pasi votimet nuk janë lejuar të mbahen në territorin e Kosovës krahasuar me vitet më parë.

Ata kanë mundur të votojnë në katër qytete në jug të Serbisë - në Vranjë, Kurshumli, Rashkë dhe Tutin. Qeveria e Kosovës kishte kërkuar që shteti i Serbisë t'i bëjë kërkesë të drejtpërdrejtë për mbajtje të zgjedhjeve, por Beogradi zyrtar nuk ka vepruar ashtu, meqë nuk e njeht shtetësinë e Kosovës. Zgjedhjet e fundit parlamentare, që Serbia i ka organizuar edhe për komunitetin serb në Kosovë, kanë qenë ato të 21 qershorit 2020. Ato zgjedhje janë mbajtur sipas një praktike të mëhershme, ku misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) i ka grumbulluar votat. Ato vota, më pas, janë numëruar në Rashkë dhe Vranjë, dy qytete kufitare të Serbisë.

Hovenieri: ShBA-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën për një të ardhme të qëndrueshme energjetike

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se shteti që përfaqëson do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme energjetike. Hovenieri në platformën "X"

ka shkruar për takimin që ka zhvilluar me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Ai ka thënë se e ardhmja energjetike e Kosovës është e ndritshme. "Shtetet e Bashkuara vazhdojnë ta mbështetin tranzicionin e Kosovës drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme

energjetike, veçanërisht përmes USAID-it dhe MCC.gov - programet. Gjithashtu, mezi presim përparimin e vazhdueshëm në udhërrëfyesin e energjisë. E ardhmja energjetike e Kosovës është e ndritshme!", ka shkruar ambasadori Hovenier.



Inaugurohet parku industrial në Viti, investim 1.7 milionësh nga Ministria e Industrisë

VITI, 19 DHJETOR - Është inauguruar Parku Industrial në Budrikë të Vitisë i cili do të jetë funksional për bizneset e Vitisë me rrethinë. Vlera e këtij investimi kap shifrën 1.7 milion euro. Me këtë rast, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky park do të japë një kontribut të rëndësishëm për rritjen e zhvillimit ekonomik dhe rajonal.

Në fjalën e tij, Kurti ka thënë se investimi kapital prej 1.7 milion eurosh nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në hapësirë prej 15.5 hektarësh në komunën e Vitisë do t'i mbështesë investimet e përgjegjshme dhe të qëndrueshme të bizneseve nga diaspora dhe investime të huaja. "Do të nxisë veprimtari prodhuese dhe përpunuese me teknologji të përparuar, do të ofrojë punësim dhe aftësim për të rinjtë tanë si

shtyllë e zhvillimit dhe transformimit progresist të vendit tonë si dhe do ta rrisë bashkëpunimin ndërmjet bizneseve", ka thënë Kurti.

Sipas kryeministrit Kurti, me hapjen e këtij parku të rinjtë do të kenë më shumë mundësi të reja për punësim në vend. "Të rinjtë tanë do të kenë më shumë mundësi të reja në vend më përpara e në vend se t'i kërkojnë ato jashtë vendit. E këtë hapësirë që po e inaugurojmë sot do ta gëzojnë së shpejti përmes thirrjeve publike rreth 30 biznese. Në tre vitet e ardhshme do të investojmë edhe 33 milionë euro për ndërtimin e parqeve të reja industriale. Përmes tyre po ofrojmë hapësirë shtesë për biznese dhe po nxisim edhe më shumë ndërmarrësinë, parakushte këto për punësim,



zhvillim dhe transformim", ka thënë Kurti, duke shtuar se "me qeverisjen tonë të deritanishme qarkullimi i bizneseve ka vazhduar të rritet gjatë periudhës janar - tetor 2023, pra sivjet. Ai ka arritur vlerën prej 15.83 miliardë eurosh

apo gati 7 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar".

Ndërsa ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se kjo zonë do të bëhet tërheqëse për

investimet e përgjegjshme edhe nga diaspora. Në anën tjetër, kryetari i Vitisë, Sokol Haliti, për këtë park nuk ka lënë pa i falënderuar edhe ish-kryeministrat e ish-ministrat. Ai pret që ky park "të lulëzojë me biznese të reja".

3.9 milionë hyrje nga Kosova drejt Shqipërisë deri në muajin nëntor



TIRANË, 19 DHJETOR - Qytetarët nga Kosova kanë kryer rreth 3.9 milionë vizita drejt Shqipërisë deri në fund të nëntorit duke u konfirmuar edhe njëherë në vend të parë dhe të padiskutueshëm në listën e vizitorëve në vendin fqinj. Vizitorët nga Kosova kanë shënuar një rritje 28 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka shkruar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në "Facebook".

9.53 milionë është shifra e

vizitorëve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë deri në prag të fundvitit. Krahasuar me periudhën janar-nëntor të vitit 2022, është shënuar rritje 33 për qind, sipas shifrave të bëra me dije nga ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, gjatë prezantimit të objektivave të lidhura me turizmin.

Muaji nëntor ka shënuar një shifër prej 547 221 hyrjesh të vizitorëve të huaj, një rritje e ndjeshme (53 për qind) më

shumë krahasuar me nëntorin e një viti më parë, çka konfirmon trendet e shtuara për ta vizituar Shqipërinë në të gjithë muajt e vitit, një tregues pozitiv i rritjes së turizmit gjithëvjetor.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka nisur përgatitjet për pjesëmarrjen e Shqipërisë në panairin ndërkombëtar Futur-Madrid dhe ITB-Berlin në të cilin Shqipëria do të jetë vendi i nderit për vitin 2025 me një program promovues njëvjeçar.

Rafuna u ofron mbështetje naftëtarëve të Kosovës

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Shoqata e Naftëtarëve ka mbajtur takimin e radhës. I pranishëm ishte edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna.

Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Bejrani, ka thënë se miratimi i Ligjit për Naftën tregon për punën që ata kanë bërë. Në këtë kontekst, ai ka falënderuar qeverinë Kurti për

mbështetjen. "Ligji i Naftës e ka treguar punën tonë se çfarë kemi bërë. Dua ta falënderoj kryeministrin për punën që është duke e bërë. Do të kërkojmë nga kjo qeveri kyçe në rrugë, e cila nuk është bërë ende", ka thënë ai.

Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka lavdëruar punën e naftëtarëve. Në këtë aspekt, Rafuna është zotuar për mbështetjen e

naftëtarëve. "Si OEK jemi munduar gjithmonë t'ju dalim në krahë. Kemi qenë pjesë e sfidave tuaja. Kërkesa jonë gjithmonë ka qenë para se të merret një vendim të diskutojnë me shoqatën. Biznesi është për t'i zbatuar vendimet, por jo pa shoqatën. Unë ju uroj që edhe vitin e ardhshëm ta bëni punën që keni bërë dhe OEK-u do të jetë gjithmonë përkrahës", ka thënë Rafuna.



Presidentja e përçarjes dhe e urrejtjes, Vjosa Osmani!



Behxhet SH. SHALA - BAJGORA

“Etërit dhe majkat Themeluese të federalizimit të Kosovës”: Etërit Kryesorë Themelues të Shteteve të Bashkuara ishin: John Adams, Benjamin Franklin, John Jay, Thomas Jefferson, James Madison dhe George Washington të cilët bashkuan Trembëdhjetë Kolonitë, drejtuan luftën për pavarësi nga Britania e Madhe dhe ndërtuan një kornizë qeverisjeje për ShBA sipas parimeve republikane në fund të shekullit të XVIII-të. Pastaj, këta i ndanë detyrat se kush do ta shkruajë Kushtetutën dhe detyrat e tjera të domosdoshme për funksionimin e shtetit. Kur Vojsa Osmani e mori mandatin e dhuruar nga Albin Kurti dhe lista Serbe + LVV dhe LDK-ë (të cilën e përçau në dysh), me të parën u thirrë në Etërit Themelues duke e karikuar dhe banalizuar me rastin e Kosovës ku, si At Themelues të Pavarësisë së Kosovës e konsideron Ibrahim Rugovën ndërkaq veten, duket, pa asnjë dyshim e konsideron si Nënë Themeluese të po kësaj pavarësie. Nëse amerikanët, si të paemancipuar politikisht që ishin, në mesin e Themeluesve të Pavarësisë së ShBA-ve nuk denjuan ta fusin asnjë femër, Vojsa Osmani, për respekt të barazisë gjinore, më shumti për veten e saj e bëri një kapërcim historik duke i lënë në hije edhe vet Etërit amerikanë të Pavarësisë. Gjatë fushatës së Albin Kurtit, në përpjekje të fitojë sa më shumë vota për të kaluar 50%, që pastaj doli se ishte e domosdoshme për të kapur të gjitha institucionet dhe për ta nënshtruar poshtërisht opozitën, si armë e fuqishme u përdorë “mjeti” se: “më në fund ka ardhur koha që familja Jashari ta japë një president të Kosovës ...”. Naivët e besuan këtë, kandidati i kësaj familje gjithashtu e besoi deri në kohën kur në sipërfaqe doli Vjosa Osmani, si trashëgimtare e familjes Jashari, që nga Epoka e


Gurit. Në të vërtetë edhe u kthyem në Epokën e Gurit. Vojsa Osmani përveç se po thirret në parimet qeverisëse të Etërve Themelues Pavarësisë së ShBA-ve, (në politikën e brendshme), edhe në politikën e jashtme po i përqafon të njëjtat vlera dhe qëndrime që i ka edhe “Sleeping Joe”, presidenti aktual i ShBA-ve (trashëgimtari biologjik dhe politik e Etërve Themelues) siç janë: angazhimi i jashtëzakonshëm në Ukrainë, politikisht dhe ushtarakisht, gjykimi i Putinit dhe Rusisë, përkrahja e gjenocidit të Izraelit në Gaza dhe kriminelit të luftës, Benjamin Natanjahu, përkrahja e Tajvanit kundër Kinës, marrja me Serbinë dhe Vuçiçin etj., varg tepër i gjatë ndonëse Vojsa është republikane e thekur, që nga koha e Republikës Socialiste të Jugosllavisë, ndërsa “Sleeping Joe” është demokrat, si të ishte anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në Ukrainë dështuan, Putinin vetëm sa e forcuan, Kina po luan si macja me miun me Tajvanin ndërsa Serbia asnjëherë nuk ka qenë më e fuqishme dhe nuk ka pasur kredite ndërkombëtare politike më të mëdha se tani. Serbia është në prag të integriteteve evropiane, Kosova po lutet t’i hiqen sanksionet nga BE-ja dhe ShBA-të, pa e sqaruar popullin pse u deshën këto sanksione. Tash, kur t’i hiqen sanksionet - masat e përkohshme, do e konsiderojnë si sukses të qeverisë dhe presidentes mercenare, Vojsa Osmani.

Në frymën e presidentëve themeltarë: Presidentja e urrejtjes dhe përçarjes, Vojsa Osmani e trashëgoi edhe një veti të presidentëve amerikanë, drejtimit të popullit në fund të vitit, kryesisht për sukseset (që nuk i ka), duke fshehur dështimet që janë të gjata sa Muri Kinez. Edhe papët e Vatikanit e kanë te rregullt

enciklikën urbi et orbi por se nuk e lidhin me fund të vitit. Si imituese dhe emetuese e keqe, Vojsa Osmani doli para Kuvendit të Kosovës, me enciklikën e saj të shkruar, mbase nga Dejana Mihalidis, andarte e shquar kundër shqiptarëve dhe Kosovës ku foli për të arriturat në planin ndërkombëtar (200 vizita turistike për mbushje të xhirollogarisë, me shpenzime të shtetit), pa përmendur dështimet në Ukrainë, Tajvan dhe Serbi. Si sukses ndërkombëtar konsiderohet acarimi i marrëdhënieve me Shqipërinë, me shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, klientelizmin në Luginë të Preshevës dhe mbrojtjen e të korruptuarve në Kosovë, shtetas të huaj, me dështetësi, nga Martin Berishaj dhe poshtë. Kontribut i jashtëzakonshëm konsiderohet afrimi i raporteve me Spanjën përmes jugosllavit që, duke i rreshkur koç... në Barcelonë merr 7500 euro në muaj. Gjithashtu, si rezultat i pamohueshëm konsiderohet njohja (imagjinare) e Kosovës nga shumica e shteteve mosnjohëse, anëtarësimi në Shoqatën për Tredhje të Demave në Gjylekarë falë angazhimit fatal dhe final të prevarantit mendjetrashë, me inteligjencë të përllorogarit IQ 5555, Besnik Bislimit. Vëreja se Etërit Themelues të shtetit të Kosovës, jo që nuk i përmendi por, përkundrazi e tha se, ndër sukseset e saj janë edhe korrigjimet nga e kaluara që i paskan rënë në hise, si Nënë Themeltare e Federalizimit të Kosovës. Të vetmet korrigjime personale që janë të dukshme janë ato fizike, materiale dhe nepotiste të cilat me një rast tjetër mund t’i arsyetojë gjerë e gjatë. E quajti veten presidente unifikuese, turpërisht e pavërtetë dhe, në këtë kontekst për të siguruar vota për federatën e ardhshme Kosovë - Serbi thirri opozitën për takim dhe

e ftoi ta ndërtojnë një qëndrim të përbashkët, si atë që e ka LVV-ja, pa mundësi tjera. Këtë cirk retorik e refuzuan AAK-në dhe PDK-në, shumë mirë bënë, po të shkonin do të koriteshin përfundimisht. Kotilla njerëzore, politike, kombëtare dhe morale ku vegjeton dhe noton presidentja e urrejtje dhe përçarjes (LVV dhe s’Guxo) si dhe partneri i koalicionit në ardhje (LDK e tredhur nga e kaluara nga një tredhaxhi dhe dredhaxhi si Lumi i Xhikës) ishin aty, në fund e bënë një foto për moto, pa Lidhjen Demokratike Komuniste ku figura qendrore ishte mercenarja e të gjitha pushteteve dhe regjimeve, të kaluara dhe të ardhshme, pa përjashtim, Limoza el Gadafi. Më habiti fakti se disa u hatëruan pse presidentja mercenare në enciklikën e saj nuk i ka përmendur Etërit Themelues të Vërtetë të Pavarësisë dhe Lirisë së Kosovës që tani po mbahen si pengje në Burgun e Hagës; presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe 10-shi i UÇK-së, Rexhep Selimi. Është e vërtetë se nuk i ka përmendur e as që do t’i përmendë, por është e pavërtetë dhe e padrejtë t’i mohohet kontributi i saj dhe kotillës ku po noton që Etërit Themelues janë ku janë. Me krenari e theksojnë këtë gjatë takimeve të fshehta, në çaste kur përrjetojnë orgazëm të urrejtjes e thonë edhe publikisht Nuk i përmend as Etërit Kryesorë Themelues të Lirisë së Kosovës dhe Bashkimit Kombëtar, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Azem Bejta dhe Shotë Galica, Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica, Gjon Serreçi dhe Marie Shllaku, Jahja Fusha dhe Rifat Berisha, Hoxhë Kadri Gjilani dhe Shyt Mareci, Komandanti Politik dhe Shpirtëror, Baca Adem Demaçi dhe Shaban Shala, Fazli Grejçevci dhe Xheladin Rekalii, Rexhep

Mala dhe Nuhi Berisha, Afrim Zhitia, Bahri dhe Fahri Fazliu, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Bajram Bahtiri dhe Agron Rrahmani, Ilaz Kodra dhe Remzi Ademaj, Komandanti Legjendar Adem Jashari me ushtarët e Prekazit, Kosovës, Shqipërisë dhe gjithë shqiptarisë dhe të gjithë ata që u përjetësuan në përmendore që për ne janë shndërruar në frymëzim kurse për antikombëtarët llogariten vetëm si varre. Etër Themeltarë të Lirisë janë Shkëlzen dhe Luan Haradinaj dhe të gjithë ata që e rrokën armën, jo për ta sjellë në pushtet një presidente si kjo që nuk është por një që ka vdekur për këtë vend edhe nëse kanë mbijetuar luftën. Nuk ka histori që do t’i përfshijë si Etër Themeltar të Lirisë dhe shtetit të Kosovës këta që pushtetin e kanë shndërruar në diktaturë, që i mohojnë vlerat e vërteta kombëtare, kontributin e tyre për këtë liri të pamërituar që e kanë, për postet që i kanë fituar me mashtrim dhe mohim të asaj në emër të së cilës edhe kanë mashtruar, që shkelin nëpër plagët e çlirimtarëve që kurrë nuk janë shëruar, që dhunojnë femra, për së dyti duke pranuar këtë që po ua kushtëzon gospodin Rohde dhe të ngjashmit, që sulmojnë Etërit e Vërtetë Themeluese për të krijuar suurogat, jo të Etërve por të njerëve dhe të bëma të tjera. Historia do i vendosë në kapitullin ku edhe e kanë vendit, Etërit dhe Majkat e federalizimit të Kosovës dhe lidhjes së pashkëputur me Serbinë. A do ta dalë kush e t’i pengojë? Sigurisht se po, historia na ka mësuar dhe na mëson se kështu do të ndodhë. Historia est magistra vitae. Për këtë vit mjaft, shkrimi i fundit do të jetë për gazetën “Epoka e re”, VETËVENDOSJE KOMBËTARE, VETËVENDOSJE JUGOSLLAVE; FILLIMI DHE FUNDI I NJË IDEALIZMI MASHTRUES!



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot zhvillohet derbi Drita - Ballkani

GJILAN, 19 DHJETOR - Sot (e mërkurë) zhvillohet derbi i madh i Superligës së Kosovës në futboll në mes të Dritës dhe Ballkanit. Kjo ndeshje është mbetur prapa nga java e tretë, pasi Ballkani kishte angazhime në Ligën e

Konferencës. Kampionët në fuqi të elitës në dy ndeshjet e fundit janë pa fitore, duke u mposhtur nga Llapi e më pas kanë luajtur baras me Prishtinën. Nga ana tjetër, Drita në pesë ndeshjet e fundit ka tri fitore dhe dy

barazime dhe do t'i kërkojë tri pikë të reja për t'i mbajtur gjallë shpresat për titull. Ballkani ka 39 pikë në vendin e parë, kurse Drita është e treta me 31 pikë. Ndeshja zhvillohet në Gjilan nga ora 13:00.



Shkëlqejnë gjimnastet e 'Elitës', kthehen me medalje nga Gjermania

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Gjimnastet e Klubit të Gjimnastikës "Elita" nga Prishtina, Bora Hoti, Kaltrina Thaqi, Vilëza Zeqiri dhe Jara Gumnishta, të udhëhequra nga trajnerët Shkumbin Maqastena dhe Abelianë Bregu, kanë marrë pjesë në turneun internacional të gjimnastikës "Gymfinity International 2023" që është mbajtur nga data 16-17 dhjetor në Grunstadt të Gjermanisë. Po në këtë turne kanë marrë pjesë edhe gjimnastet e Kubit të Gjimnastikës "Fushë-Kosova". Në këtë turne kanë marrë pjesë shumë garues nga shumë ekipe dhe vende të ndryshme të botës. Në turneun "Gymfinity International 2023" gjimnastet nga Kosova kanë shkëlqyer duke rrëmbyer medalje të arta, të argjenda dhe të bronzta nëpër të gjitha kategoritë dhe disiplinat e këtij sporti atraktiv.

Klubi i Gjimnastikës "Elita" në "Facebook" ka njoftuar se gjimnastja Bora Hoti ka arritur të tubojë gjithsej 44.4 pikë, duke rrëmbyer vendin e parë në të gjitha disiplinat. Po ashtu, suksese të jashtëzakonshme kanë arritur edhe Kaltrina Thaqi, Vilëza Zeqiri dhe Jara Gumnishta të cilat kanë arritur të stolisen me medalje të arta, të argjenda dhe të bronzta. "Aktivitetet dhe rezultate të tilla janë motivuese për sportistët tona, të cilat me shumë punë dhe me kushte jo të barabarta infrastrukturore janë të guximshme për të konkurruar dhe fituar me shtetet që kanë traditë gjimnastikën. Prindër, faleminderit që jeni mbështetja jonë më e madhe! Pa ju 'ELITA' nuk do të ishte një familje kaq e plotësuar. Faleminderit Wachmeister! Projekte të tjera na presin", thuhet në njoftimin e Klubit "Elita".



Rahoveci është kampion vjeshtor, 14 fitore rresht për 'vreshtarët'



RAHOVEC, 19 DHJETOR - Rahoveci është kampion vjeshtor në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). "Vreshtarët" i kanë fituar të gjitha 14 ndeshjet e pjesës së parë të edicionit garues 2023/2024. I bie që Rahoveci ka mposhtur nga dy herë të gjitha skuadrat. Ka fituar dy herë ndaj kampiones në fuqi, Besa Famgasit, po ashtu dy herë ndaj fitueses së Kupës, Trepçës. Me 603 gola të shënuara, Rahoveci ka sulmin bindshëm më efikas. Ndërkohë ka pranuar 404 gola, dy më shumë se Besa Famgas. Rahoveci dimëron në

krye me 28 pikë, Besa është e dyta, por ka gjashtë pikë më pak - 22. Trepça ka 20 pikë në vendin e tretë. Rahoveci ka disa vjet që shquhet për organizim dhe seriozitet. Nivelin e organizimit e ka rritur edhe më shumë në verë dhe kjo solli fitoret rresht. Ka angazhuar lojtarë cilësorë vendorë e të huaj, po ashtu bëri ndryshime në shtabin teknik. Ka pasur edhe përkrahje të mirë nga shikuesit, ndërsa me paraqitjet në vjeshtë ka dëshmuar se është kandidat i fuqishëm për dy trofetë e këtij edicioni: titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës.

Breitenreite, kandidat për selektor të Kosovës

Prishtinë, 19 dhjetor - Trajneri gjerman Andre Breitenreite është kandidati më serioz për ta marrë drejtimin e kombëtares së Kosovës në futboll. Siç raportojnë mediet zvicerane dhe gjermane, Breitenreite tashmë është

takuar me drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës. Në ditët në vijim pritet të ketë zhvillime të reja në këtë drejtim. Trajneri 50-vjeçar është pa punë që nga shkurti i këtij viti, kur i ndau rrugët me skuadrën gjermane

Hoffenheim. Breitenreite suksesin më të lartë si menaxher e ka arritur me skuadrën e FC Zurichut duke e udhëhequr drejt titullit të kampionit të Zvicrës në vitin 2021. Ai tashmë njeh disa nga lojtarët kosovarë nga koha e tij

në Zvicër, duke përfshirë Fidan Alitin dhe Mirilind Kryeziun, të cilët ishin pjesë e ekipit të tij. Përndryshe, Kosova është në kërkim të një trajneri, pasi Primozh Glihes nuk iu vazhdua kontrata për shkak të mungesës së rezultateve.



Rritet vlera e Zhegrovës në treg

LILLE, 19 DHJETOR - Sulmuesi Edon Zhegrova po vazhdon me paraqitje të shkëlqyera në kampionatin francez këtë sezon me fanellën e ekipit të Lilles. 24-vjeçari në këtë edicion të ri të garave është paraqitur në 15 ndeshje në ligë me ekipin francez, teksa në 12 prej tyre e

ka nisur nga minuta e parë. Zhegrova ka shënuar një gol dhe ka bërë katër asistime deri në këtë fazë të sezonit. Kjo formë e jashtëzakonshme e Zhegrovës ka bërë që vlera e tij në treg, sipas "Transfermarkt", të rritet për dy milionë euro. Kartoni i tij në treg tani

vlerësohet hiq më pak se dhjetë milionë euro. Anësori i djathtë është paraqitur edhe në Ligën e Konferencës, ku në gjashtë ndeshje të luajtura ka qenë autor i një goli dhe një asistimi. Zhegrova është bërë pjesë e Lilles në janar të vitit të kaluar pas një aventure në Zvicër me

fanellën e Baselit, për shumën e shtatë milionë eurove. Ai ka kontratë me ekipin francez deri në qershor të vitit 2026, por në rast se vazhdon me paraqitje të tilla, nuk do të ishte befasi në rast se në një të ardhme të afërt ta shohim në ndonjë ekip më të madh.



Çaste ankthi për familjen e portierit të PSG-së, gruaja e tij goditet nga hajdutët

PARIS, 19 JANAR - PSG-ja dhe futboli francez në tërësi është tronditur nga një ngjarje e rëndë. Portieri i tretë i PSG-së, Alexandre Letellier, jetoi një makth të vërtetë, së bashku me familjen e tij të hënën mbrëma. Ai ishte "viktimë" e një grabitjeje nga tre hajdutë, që hynë në shtëpinë e tij në Yvelines. Krahas bastisjes në shtëpi nga kriminelët, portieri parisien u mor peng, së bashku me gruan dhe fëmijët e tij 2 dhe 6 vjeç nën kërcënimin me thikë. Momente ankthi autentik për të gjithë familjen. Në Francë raportojnë se një nga hajdutët ka goditur në fytyrë edhe gruan e Letellier, duke e bërë edhe më dramatike historinë. Për fat të mirë, gjithçka mbaroi para se gjendja e saj të përkeqësohej. Hyrja e hajdutëve ka bërë që të bjerë alarmi, i cili ka sinjalizuar menjëherë policinë, që ka mbërritur në vendngjarje dhe ka mundur të kapë kriminelët e t'i arrestojë. Ata janë dy të mitur, 16 vjeç dhe një më i rritur 21 vjeç. Në



vend është gjetur edhe një thikë, me gjasë ajo e përdorur për ta kërcënuar familjen, por gjithçka do të duhet të konfirmohet pas përfundimit të hetimeve. Një punonjës policie, ndër të tjera, ka mbetur i plagosur në gju gjatë arrestimit të tre hajdutëve. Tek të dyshuarit janë gjetur edhe sende të ndryshme të vjedhura nga shtëpia. Nën kërcënimin e një thike, sulmuesit dyshohet se kërkuan

para dhe bizhuteri nga Letellier dhe familja e tij. Nuk është hera e parë që diçka e tillë ndodh brenda skuadrës së PSG-së. Në të kaluarën kishte ndodhur edhe me lojtarë të tjerë të kalibrit të Marquinhos, Thiago Silva, Di Maria, Dani Alves, Choupo-Moting, Sergio Rico dhe Icardi. Viti 2021 ishte një vit i zi me katër futbollistë të grabitur në shtëpi. I fundit ishte Donnarumma, verën e kaluar.

Minnesota merr frenat e renditjes në Perëndim, humbasin lakersat, Indiana dhe Miami



MIAMI, 19 DHJETOR - Minnesota surpriza e këtij sezoni jo vetëm konsolidon kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit, por thellon edhe renditjen me rivalët pas fitores me rezultat 112-108 në fushën e Miamit. Edwardsi me 32 pikë ishte lider për Minnesotan, që bëhet ekipi i parë në Perëndim që arrin 20 fitore. Fitore të thellë korri Denveri, që mundi me rezultat 130-

104 Dallasin, ndeshje ku Murray realizoi 22 pikë e Gordoni 21. Zhgënjën skuadra e lakersave, që në shtëpi u mund me shifrat 114-109 nga New Yorku. Brundson me 29 pikë e Randle me 27 bënë dallimin në fushë për nju-jorkezët, ndërsa 57 pikët e dyshes James-Davis mbetën për statistikë. Befason Chicago, që fitoi me rezultat 108-104 në fushën e

Philadelphias, ndeshje me rivalitet, ku për miqtë u dallua White me 24 pikë. Pas kohës shtesë fitoi Clevelandi, që mundi me rezultat 135-130 Houstonin (Mitchelli 37 pikë). Jashtë fushës triumfoi ekipi i clippersave, që falë 35 pikëve të Hardenit, mundi me rezultat 151-127 Indianan.

REZULTATET

Cleveland - Houston	135-130
Indiana - Clippers	127-151
Philadelphia - Chicago	104-108
Atlanta - Detroit	130-124
Miami - Minnesota	108-112
Toronto - Charlotte	114-99
Oklahoma - Memphis	116-97
Denver - Dallas	130-104
Utah Jazz - Brooklyn	125-108
Sacramento - Washington	143-131
Lakers - New York	109-114

Kroosi rikthehet në Kombëtaren e Gjermanisë

Ekipi kombëtar gjerman do të marrë një shtysë të madhe në prag të Kampionatit Evropian i cili do të mbahet në këtë vend vitin e ardhshëm. Përkatesisht, portali "Kicker" bëri me dije se Toni Kroos (33) ka vendosur ta

pranojë ftesën e trajnerit të Gjermanisë, Julian Nagelsmann dhe t'i japë fund pensionimit të tij nga kombëtarja. Lojtari i Real Madridit i dha lamtumirën kombëtares gjermane në verën e vitit 2021, pasi "Panzerët" u

eliminuan nga Anglia në fazën e 1/8-tës në Kampionatin Evropian. Tani ai është sërish gati për t'u vënë në dispozicion të kombëtares dhe do të tentojë t'i çojë gjermanët drejt titullit të kampionit të Evropës. Dyshohet

se motivi kryesor i tij për t'u rikthyer është fakti se fëmijët e tij do ta shikojnë atë duke luajtur "Euro 2024" me fanellën e kombëtares në shtëpi, pra në fushën e tij. "Euro 2024" luhet nga 14 qershori deri më 14 korrik

2024 dhe Gjermania është vendosur në Grupin A me Skocinë, Hungarinë dhe Zvicrën. Kroos deri më tani ka luajtur 106 ndeshje me fanellën e Gjermanisë, në të cilat ka shënuar 17 gola.

SHKURT

Reja: Jam i lumtur për kualifikimin e Shqipërisë, nuk ndihem xheloz

Ish-trajneri i Shqipërisë, Eduardo Reja, u shpreh se nuk ndihet aspak xheloz për kualifikimin e madh të arritur nga kuqezinjtë e Silvinhos në "Euro 2024". "Jo, aspak. Ishte një vazhdimësi e punës së nisur disa vjet më parë. E gjeta Shqipërinë në një moment pak të vështirë dhe u munduam të ndryshojmë. Edhe kundërshtarët ishin më të fortë, pasi Polonia e këtij edicioni ishte më e dobët se ajo që u përballëm ne. Gjithsesi skuadra është cilësore dhe Sylvinho ka bërë një punë të mirë. Jam shumë i kënaqur që djemtë ia dolën dhe jam edhe pjesërisht kënaqur për atë sukses të tyre", ka thënë Reja.

Abrashi në formacionin e javës në Zvicër

Mesfushori shqiptar Amir Abrashi po vazhdon me paraqitje mbresëlënëse në elitën e futbollit zviceran me fanellën e Grasshoppersit. 33-vjeçari është bërë pjesë e formacionit të javës nga "SofaScore" për xhiron e 18 të kampionatit elitaz zviceran, pas paraqitjes së tij fantastike në duelin ndaj Yverdon-Sport. Abrashi, i cili gjithashtu mban shiritin e kapitenit, u paraqit në këtë ndeshje për 90 minuta duke qenë një nga lojtarët më të dalluar në fushë. Abrashi pati dy goditje në drejtim të portës, tetë duela të fituara në fushë, pesë ndërhyrje dhe një ndërprerje të aksionit, duke qenë lojtari më i vlerësuar tek ekipi i tij me notën 7.6.

Formacioni: Ati, Ottiger, Staniq, Katiq, Schmid, Steffen, Abrashi, Witzig, Tasar, Media, Males.

Lajm i mirë për Cityn, rikthehet De Bruyne

Pep Guardiola më në fund merr lajme fantastike nga infermeria. Kevin De Bruyne është rikthyer të stërvitet me pjesën tjetër të ekipit. Mesfushori belg ka qenë një mungesë shumë e madhe për strategun spanjoll, teksa roli i De Bruyne të Manchester City është jetik. City ndodhet në Arabi, aty ku po bëhet gati për Botërorin për klube. De Bruyne është stërvitur rregullisht me pjesën tjetër të ekipit, me sa duket ka lënë pas plotësisht dënimin e pësuar në tendinat e gjurit.

Van de Beek pritet të huazohet në Frankfurt

I afruar me shumë bujë te Manchester Unitedi në vitin 2020 nga radhët e Ajaxit, Donny van de Beek nuk mundi për asnjë moment të shndërrohej në një lojtar të rëndësishëm për "Dajtë e Kuq". Holandezi përfundoi sezonin e shkuar në huazim tek Evertoni, ndërsa tashmë "paketon" sërish valixhet dhe përgatitet për një përvojë të re në Gjermani tek Eintracht Frankfurti. Unitedi dhe Frankfurti kanë arritur marrëveshjen për transferimin e lojtarit nëpërmjet formulës së huazimit me gjermanët që do të paguajnë 11 milionë euro, plus katër të tjera në formën e bonuseve.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit 03/L-2012 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 7 dhe 8 paragrafi 1 pika b, si dhe paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022 dhe Vendimit nr.4789 të datës 19.12.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURSI JASHTËM

Pozita e Punës: Punëtor Sigurimi

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja: Në afat të pacaktuar

Periudha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: XXI

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

1.Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme, licencë për Sigurim Fizik
- Përvojë pune 1 vit
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
 - Dëshmi mbi shkollimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
 - Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.
- Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme: Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë punëtorët e rregullt të NPK "Trafiku Urban" SHA. Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

- Kandidati/ja, mund t'i dorëzojë këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban, përmes postës, dhe në formë të skanuar përmes email: punesimi@trafikurban-pr.com;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;

Konkursi është i hapur nga data **20.12.2023** dhe përfundon më datë **03.01.2024** në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të nenit 8 të Ligjit 03/L-2012 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 7 dhe 8 paragrafi 1 pika b, si dhe paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022 dhe vendimit me nr. 4790 të datës 19.12.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, shpall:

KONKURSI JASHTËM

Pozita e punës: Zyrtar/e Ligjor (1 pozitë).

Numri i pozitave: 1 (një);

Kohëzgjatja: Në afat të pacaktuar;

Periudha provuese: 3 muaj

Niveli i pagës: VIII.

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Përgatitja profesionale

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik;
- 2 vite përvojë pune profesionale
- Aftësi shumë të mira të punës më kompjuter;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etik profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;

2. Dëshmi mbi shkollimi;

3. Dëshmi mbi përvojën e punës ;

4. Kopja e letërnjoftimit;

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

- Kandidati/ja, mund t'i dorëzojë këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban, përmes postës, dhe në formë të skanuar përmes email: punesimi@trafikurban-pr.com;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;

Konkursi është i hapur nga data **20.12.2023** dhe përfundon më datë **03.01.2024** në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



U prilogëlanu 8. Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima, i Pravilnika br.01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta broj 1827 od 13.07.2022.godine kao i Rešenje br.4789 od 19.12.2023. godine načelnik NPK-U33 Saobraćaj" SH, Priština, saopštava:

JAVNI KONKURS

Radno mesto: radnik u osiguranju

Broj pozicija: 1 (jedan)

Trajanje: Na neodređeno vreme

Probni period: 3 meseca

Nivo plate: XXI.

Dužnosti i odgovornosti:

Što se tiče radnog mesta, možete ga pronaći na sajtu: www.trafikurban-pr.com, u kartici - O nama, Izveštaji/Pravilnik

Stručna priprema:

- Srednjoškolska diploma, licenca za fizičko osiguranje
- 1 godina radnog iskustva
- Veoma dobro poznavanje rada na računaru;
- Dobre organizacione i komunikacione veštine;
- Profesionalna etika i biti sposoban da radi pod pritiskom.Potrebna dokumentacija.

Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
 - Dokaz o obrazovanju;
 - Kopija lične karte;
 - Dokaz o radnom iskustvu
 - Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci
 - Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurirate su prednost;
- Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primene:

Prijava se može izvršiti u fizičkom obliku u zatvorenim kovertama u kancelariji br. 5 Gradskog saobraćaja, poštom ili putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com, Konkurs je otvoren od 20.12.2023 i završava se 03.01.2024 do 16:00 časova.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Na osnovu člana 8 Zakona o radu 03/L-2012, člana 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju tenderskih procedura u javnom sektoru, člana 7 i 8 stav 1 tačka b, kao i stav 2 i 3 Uredbe br.1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima, Uredbe br.01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta sa br. 1827 od 13.07.2022 i rešenje br. 4790 od 19.12.2023.godine, glavni izvršni direktor NPK „Urbani saobraćaj“ dd – Priština, saopštava:

JAVNI KONKURS

Radno mesto: Pravni službenik (1 radno mesto).

Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme.

Probni period: 3 meseca

O obavezama i odgovornostima posla možete se informisati putem veb-a: www.trafikurban-pr.com, u kartici - O nama, Izveštaji/Redovno.

Stručna priprema

- Univerzitetska diploma, Pravni fakultet, diplomirani ili master nivo;
- 2 godine profesionalnog radnog iskustva
- Veoma dobro poznavanje rada na računaru;
- Dobre organizacione i komunikacione veštine;
- Profesionalna etika i sposobnost rada pod pritiskom;

Potrebna dokumentacija:

Kandidat, ove dokumente moram dostaviti u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;

1. Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa web stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacioni-shk.html>;

2. Dokaz o stručnoj spremi;

3. Dokaz o radnom iskustvu;

4. Kopija lične karte;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primene:

Način primene:

• Kandidat može dostaviti ove dokumente u fizičkom obliku kancelarijama za gradski saobraćaj, poštom, a u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;

- • Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;

Konkurs je otvoren od **20.12.2023** i završava se **03.01.2024** u **16:00** časova.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

Datum: 19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.4792 të datës 19.12.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Zyrtar për Arkivë Qendrore dhe Administrative

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja: 120 ditë

Niveli i Pagës: XVIII

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë Universitare apo shkollim i mesëm;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet përmes emailit: punesimi@trafikurban-pr.com, në formë fizike dhe përmes postës.

Konkursi është i hapur nga data **20.12.2023** dhe përfundon më datë **03.01.2024** deri në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.4791 të datës 19.12.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

KONKURS I JASHTËM

Pozita e Punës: Zyrtar për Protokoll

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja: Deri në kthimin e punëtores nga pushimi lehonisë

Niveli i Pagës: XVI

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë Universitare apo shkollim i mesëm;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet përmes emailit: punesimi@trafikurban-pr.com, në formë fizike dhe përmes postës.

Konkursi është i hapur nga data **20.12.2023** dhe përfundon më datë **03.01.2024** deri në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

1



Data: 19.12.2023

U prilog članu 8 i članu 10 stav 2 tačka 2.3 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Pravilnik br.01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta sa br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.4792 od 19.12.2023.godine, Izvršni direktor NPK „Trafiku Urban“ SH, Priština, objavljuje:

JAVNI KONKURS

Radno mesto: Službenik za centralnu i administrativnu arhivu

Broj pozicija: 1 (jedan)

Trajanje: 120 dana

Nivo plate: XVIII

O obavazama i odgovornostima posla možete se informisati putem veb-a:

<https://www.trafikurban-pr.com>, u kartici - O nama, Izveštaji/Redovno.

Kvalifikacije i veštine:

- Univerzitetska diploma ili srednje obrazovanje;
- 1 godina radnog iskustva;
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- da se protiv podnosioca prijave ne vodi krivični postupak;

2. Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost.

Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna izmena informacija datih u gornjoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

Način primene:

Prijava se može izvršiti putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com, u fizičkom obliku i poštom.

Konkurs je otvoren od **20.12.2023** i završava se **03.01.2024** do **16:00** časova.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 6, stav 5, tačka 5.1 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.4791 od 19.12.2023.godine, Izvršni direktor NPK „Trafiku Urban“ SH, Priština, objavljuje:

JAVNI KONKURS

Radno mesto: Službenik za protokol

Broj pozicija: 1 (jedan)

Trajanje: Do povratka radnice sa porodiljskog odsustva

Nivo plate: XVI

Dužnosti i odgovornosti:

Što se tiče radnog mesta, možete ga pronaći na sajtu: www.trafikurban-pr.com, u kartici - O nama, Izveštaji/Pravilnik.

Kvalifikacije i veštine:

- Univerzitetska diploma ili srednje obrazovanje;
- 1 godina radnog iskustva;
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Nema krivičnog postupka protiv podnosioca predstavke.

Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost.

Svaki materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gornjoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

Način primene:

Prijava se može izvršiti putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com, u fizičkom obliku i poštom.

Konkurs je otvoren od **20.12.2023** i završava se **03.01.2024** do **16:00** časova.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 19.12.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

2

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Mecis" SH.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811976432 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "Mecis" D.O.O. Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811976432 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Mecis" L.L.C. with headquarters Obiliq, has come to the decision to quit its business: 811976432 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Shala Gas" Sh.p.k, Suharekë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Deponin e gazit të lëngët naftor në zonën industriale, në Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.01.2024 në ora 10:00 në SH. M. T Skender Luarasi, Suharekë, do të organizohet Debat Publik nga Kompania "Shala Gas" Sh.p.k - Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphaD1o3bW8vcxkxV0R0T09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Shala Gas" Sh.p.k - Suharekë, për Deponin e gazit të lëngët naftor në zonën industriale në Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lendita Alijaj nga Rracaj KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Dy Dëshmorët " Sheremet KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

